

Bazuar në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 75 dhe VKA nr. 5, datë 14. 08. 2020 “Për shtesa e ndryshime në Rregulloren nr. 3/2, datë 26.02.2008 “Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” dhe sipas Urdhrit Nr. 6222 prot., datë 13.08.2024 të Drejtorit Rajonal të Sigurimeve Shoqërore Fier “Për hapjen e procedurës së rekrutimit të personelit nëpërmjet konkurimit të hapur”, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier, bën shpalljen e vendit të lirë të punës për pozicionin:

## **DRSSH Fier**

1. Inspektor Bujku (Njësia Administrative Ballagat), ALSSH Fier  
1 vend pune

### **Kandidati konkurues :**

- Duhet të zotërojnë diplomë Universitare e Nivelit të Parë/Bachelor të barazvlefshëm me të, sipas legjislacionit të Arsimit të Lartë.

### **Kërkesat e përgjithshme specifike**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të ketë jetë në kushte shëndetësore që lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore, shërbimi civil ose administrata publike, që nuk është shënuar, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi me shkrim & intervista**

- Njohuritë në fushën e Sigurimeve Shoqërore (statusi i ISSH, Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”
- Njohuri të Rregulloreve financiare, të përfitimeve, kontributeve dhe për sistemin e informacionit të ISSH
- Njohuri të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat";
- Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë,
- Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008 Për mbrojtjen e të dhënave personale",
- Ligji Nr .9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike,
- Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

Në vlerësimin e kandidatëve përfshihen :

- vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve: që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën;

- vlerësimi me shkrim: që konsiston në vlerësimin e njohurive për legjislacionin e zbatueshëm për sigurimet shoqërore, organizimin administrativ në sistemin e sigurimeve shoqërore, për nivelin e njohurive akademike dhe profesionale, bazuar në kriteret e përcaktuara;
- intervista me gojë ku zhvillohet intervistimi i kandidatëve, i cili synon të evidentojë formimin e përgjithshëm, si dhe vizionin e tyre mbi veprimtarinë e sigurimeve shoqërore dhe për pozicionin që konkuron.

**Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:**

- për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, **deri në 20 pikë**;
- për intervistën me gojë, **deri në 40 pikë**;
- për vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë.
- Kandidatët konkurues kualifikohen nëse në total ka fituar **mbi 70 pikë**, nga 100 pikë të mundëshme, gjatë fazës së vlerësimit

#### **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat në zyrën e protokollit të DRSSH-së Fier si më poshtë:

- Një kërkesë për konkurim për pozicionin e punës për të cilin është i interesuar.
- Një kopje e jetëshkrimit (CV);
- Fotokopje e diplomës dhe listës së notave (e noterizuar);
- Vërtetim i gjendjes gjyqesore;
- Raport të aftësisë për punë
- Fotokopje e librezës së punës;
- Certifikatë ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;
- Fotokopje e Kartës së Identitetit

**Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet brenda datës 21.08.2024**, pranë zyrës së protokoll / sekretarisë në DRSSH Fier.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më lartë.

**Testimi me shkrim** do të zhvillohet në ambjentet e DRSSH Fier në datën **26.08.2024, ora 10:00**

**Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambjentet e DRSSH Fier në datën **28.08.2024. ora 10:00**